

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.137/2020, “PËR BUXHETIN E VITIT 2021, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i hartimit të këtij akti normativ është sigurimi i fondit të nevojshëm nëpërmjet një ndryshimi në shpenzimet buxhetore, konkretisht nëpërmjet rialokimit midis dy elemnteve të fondit rezervë, për përballimin e shpenzimeve për blerjen e vaksinës nga kompania turke “*Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret*”, A.Ş. të krijuar nga *Sinovac Life Science Co, Ltd.* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës. Shuma totale është 10 000 000 (dhjetë milionë) USD, e konvertuar në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit në datën e pagesës, rreth 1.1 miliardë lekë. Instituti i Shëndetit Publik është institucioni që do të kryejë pagesën e dozave të vaksinave.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky akt normativ nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të vitit 2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Sipas nenit 3, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar “Fond rezervë” është fondi që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit dhe sipas nenit 5, të po këtij ligji, ky fond përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Me qëllim parandalimin e infektimit me Sars-Cov-2, shumë kompani farmaceutike janë mobilizuar për të prodhuar vaksina kundër këtij virusi. Ndër to, Shqipëria është furnizuar tashmë nga kompania *Pfizer* dhe *AstraZeneca* të

cilat u alokuan nëpërmjet mekanizmit *Covax* dhe nëpërmjet marrëveshjes së firmosur me *Pfizer*. Ndërkohë, Shqipëria, me anë të aktit normativ nr.6, datë 10.3.2021, dhe aktit normativ nr.7, datë 12.3.2021, dhe mbështetur edhe në vendimet e Komitetit të Ekspertëve për Imunizimin, komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri dhe Komiteti i Etikës, i ka hapur rrugë përdorimit në popullatë të vaksinave që kanë marrë një aprovim për përdorim në popullatë përveçse nga EMA dhe FDA edhe ato që janë të certifikuara prej trupave të tjera certifikuese të vendeve që prodhojnë vakcina anticovid-19.

Në këtë situatë, Shqipëria mori një shprehje interesi nga kompania turke “*Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret*”, A.Ş. për të na furnizuar me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19 (*vero cell*) *Coronovac*, të krijuar nga *Sinovac Life Science Co, Ltd.* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës.

Shuma totale është 10 000 000 (dhjetë milionë) USD, e konvertuar në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit në datën e pagesës, rreth 1.1 miliardë lekë. Instituti i Shëndetit Publik është institucioni që do të kryejë pagesën e dozave të vaksinave.

Zhvillimi i një vaksine kundër Covid-19 është një proces, i cili është duke u zhvilluar me ritme shumë të shpejta, për shkak të vetë situatës emergjente që kërkon zbulimi i një metode efektive për parandalimin e përhapjes së këtij virusi. Kësisoj ishte e paparashikueshme se kur mund të ofrohej mundësia e prokurimit të një vaksine efektive nga ana e Shqipërisë, si rrjedhim parashikimi i një fondi specifik në buxhet për prokurimin e vaksinës ishte i pamundur për sa kohë nuk dihej çmimi, numri i dozave të mundshme për prokurim dhe as kostot e tjera që shoqërojnë procesin.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101, të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijojnë¹:

¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 10.11.2006

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:

Neni 101 ka parashikuar ‘nevojën’ dhe ‘urgjencën’ si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2021, pasi ka marrë dijeni mbi kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për fonde shtesë në masën rreth 1.1 miliardë lekë, me qëllim financimin e kryerjes së pagesave për sigurimin e vaksinave të nevojshme për përballimin e situatës pandemike. Kjo, bazuar në:

- Aktin normativ “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, ndërmjet distributorit “Keymen Ilaç Sanayi Ve Ticaret”, A.Ş. dhe ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19 (Vero Cell) Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës”;
- Projektvendimin “Për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave që rrjedh nga marrëveshja, ndërmjet distributorit “Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret” A.Ş. dhe ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19 (vero cell) Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës”.

Ky rishikim propozohet t’i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, aspekti i nevojës dhe emergjencës të së cilit lidhet pikërisht me nevojën imediate për kryerjen e pagesave në fjalë, përmes fondit rezervë të buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

2. Përkohshmëria

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i

Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky akt normativ nuk synon në përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Akti normativ përcakton vetëm një ndryshim në shpenzimet buxhetore, një rialokim midis dy elementeve të fondit rezervë dhe, përkatësisht,:

- **Shtesën me 1 miliardë lekë në fondin rezervë të Këshillit të Ministrave** – Me qëllim përballimin e shpenzimeve të blerjes së vaksinave gjatë vitit 2021, si edhe të shpenzimeve të tjera eventuale të qeverisë që lidhen me pandeminë Covid-19;
- **Pakësimin me 1 miliardë lekë të rezervës për studime e projekte** – në kuadër të riorientimit të prioriteteve të qeverisë gjatë situatës pandemike Covid-19, për vitin 2021, projekte që do të shtyhen për 6-mujorin e dytë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij akti normativ ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky akt normativ është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky akt normativ nuk prek parametrat kyç makro-fiskal, siç janë: të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme, defiçiti buxhetor dhe borxhi publik, të cilët mbeten të pandryshuar.

KËSHILLI I MINISTRAVE

TREGUESIT FISKALE TE BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2021
FISCAL INDICATORS REGARDING CONSOLIDATED BUDGET OF 2021

ne milion leke (in million lek)

Nr.	EMERTIMI	Buxheti 2021 AL	% % te PDB	ITEMS
	TOTALI TE ARDHURAVE	487,828	39.0%	TOTAL REVENUE
I.	Te ardhura nga ndikmat	20,243	1.3%	Grants
	<i>Nga te cilat: mbeshtetje buxhetore</i>	<i>9,353</i>	<i>0.6%</i>	<i>from which: Budget Support</i>
	<i>Nga te cilat: projekte te destinuar per investime</i>	<i>11,000</i>	<i>0.7%</i>	
II.	Te ardhura tatimore	445,573	28.3%	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	219,592	19.0%	From tax offices and customs
	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	182,061	9.0%	V.A.T
	Tatimi mbi Fitimin	33,031	2.0%	Profit Tax
	Akcizat	45,000	2.9%	Excise Tax
	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	41,000	2.4%	Personal Income Tax
	Taksa Nacionale dhe te tjera	35,000	2.5%	National Taxes and others
	Taksa Doganore	5,500	0.4%	Customs Duties
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	25,426	1.5%	Local Taxes
	Taksa Lokale	19,776	1.2%	Local Taxes
	Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	5,650	0.3%	Property Tax
II.3	Te ardhurat nga Fondet Speciale	100,555	6.6%	Revenues from Special Funds
	Sigurimi Shoqeror	85,471	5.1%	Social insurance
	Sigurimi Shendetesor	14,084	0.8%	Health insurance
	Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve	1,000	0.1%	Revenues for owners' in value-compensation
III.	Te ardhura Jotatimore	21,600	1.3%	Nontax Revenue
	Tran.Fitimi nga Banka e Shoqiperise	1,000	0.1%	Profit transfer from BOA
	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	12,000	0.7%	Income of budgetary institutions
	Dividenti	300	0.0%	Divident
	Tarifat e Sherbimeve	2,800	0.2%	Services Fees
	Te tjera	5,500	0.3%	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	594,221	33.4%	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	467,769	27.9%	Current Expenditures
1	Personell	21,834	3.5%	Personnel expenditures
	Paga	71,085	4.3%	Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	11,659	0.7%	Social insurance contributions
	Fondi i vecante i pagave	280	0.0%	Bonus fund
	Politika te reja pagash	1,000	0.5%	Contingency for new wage policies
	Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta	900	0.0%	Higher Education from its own revenues
2	Interesat	43,800	3.5%	Interest
	Te Brendshme	24,300	1.4%	Domestic
	Te Huaja	15,000	0.9%	Foreign
	Kontingjencë për risqet e borxhit	4,500	0.3%	Contingency for debt related risks
3	Shpenzime Operative Mirembajtje nga te cilat:	49,884	3.0%	Operational & Maintenance of which:
	<i>Te qeverisjes qendrore</i>	<i>46,538</i>	<i>2.8%</i>	<i>Central government</i>
	<i>Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta</i>	<i>800</i>	<i>0.0%</i>	<i>from revenues of Higher Education System</i>
	<i>Te tjera jashte limitit</i>	<i>2,550</i>	<i>0.2%</i>	<i>from Exceptional Revenues</i>
4	Subvencionet	1,840	0.1%	Subsidies
5	Shpenzime per Fondet Speciale	136,171	11.5%	Social insurance outlays
	Sigurime Shoqerore	142,265	3.5%	Social insurance
	Politika te reja pensionesh	2,400	0.1%	Contingency for new pension policies
	Bonusi i Pensionistev			Pensioners' Bonus
	Sigurime Shendetesore	47,606	2.8%	Health insurance
	Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	3,000	0.2%	Expenditure for owners' in value-compensation
6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	86,826	3.4%	Local Budget expenditure
	Transferrat nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor	27,050	1.5%	Central Government Grant for Local Government
	<i>Transferte e pakushtezuar e pergjithshme</i>	<i>13,450</i>	<i>1.1%</i>	<i>Unconditional Fund</i>
	<i>Transferte e pakushtezuar sektoriale (Grant Specific)</i>	<i>8,100</i>	<i>0.5%</i>	<i>Specific Grant</i>
	<i>Transferte per emergjencat civile</i>	<i>500</i>		
	Buxheti vendor (te ardhurat e veta tatimore)	23,426	1.5%	Local Budget (Own revenues)
	Taksa te ndara	900	0.1%	Local Budget (from shared taxes revenues)
	Buxheti vendor (te ardhurat e veta jo-tatimore)	2,700	0.2%	Local Budget (from non-tax revenues)
	Financimi i huaj vendor	750	0.0%	Local foreign financing
7	Shpenzime te tjera	33,700	1.7%	Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	800	0.0%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike dhe Paaftesia	24,700	1.5%	Social assistance and disability
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	1,000	0.1%	Compensation for ex political prisoners
	Bonusi i lindjeve	2,200	0.1%	Birth Bonus
II.	Fondi Rezerve	5,000	0.5%	Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezerve	4,000	0.2%	Reserve Fund
	Rezerve per zgjedhjet	1,000	0.1%	Contingency for deficit financing
III.	Shpenzime Kapitale	123,452	7.3%	Capital expenditures
	Financimi Brendshem	60,024	3.5%	Domestic financing
	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	1,000	0.1%	From Higher Education System's own revenues
	Financimi Huaj	24,428	3.0%	Foreign financing
	<i>nga te cilat: Energjia</i>	<i>2,500</i>	<i>0.1%</i>	<i>from which: Energy</i>
	Fondi i Rindertimit	38,000	1.7%	
	DEFICITI	-106,393	-4.3%	Cash Balance
	FINANCIMI DEFICITIT	106,393	6.3%	Financing (Cash)
	Brendshem	85,443	4.7%	Domestic
	Te ardhura nga privatizimi			Privatization receipts
	Hua-marreje e brendshme	49,000	3.0%	Domestic borrowing
	Te tjera	36,443	2.7%	Other
	Huaj	20,950	0.8%	Foreign
	Hua afatgjate (e marre)	24,173	1.4%	Long-term Loan(Drawings)
	Ndryshimi i gjendjes se arkas			Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-40,890	-2.4%	Repayments
	Mbeshtetje buxhetore	25,767	1.8%	Budget support